

Prindërimi shumëgjuhësor: është fantastik!

I dashur prind,

'Kind en Gezin' ju ofron të gjithë mbështetjen që keni nevojë për zhvillimin gjuhësor të fëmijës tuaj dhe prindërimin shumëgjuhësor. Prindër, gjyshe dhe gjyshër, ata që kujdesen për familjen tuaj, vëllezër dhe motra... të gjithë këto ofrojnë kushte që fëmija juaj të mësojë një ose më shumë gjuhë.

Për këtë arsye kemi përkthyer informatat më të rëndësishme mbi zhvillimin gjuhësor, stimulimin gjuhësor dhe Prindërimi shumëgjuhësor.

Më shumë informata mund të gjeni në broshurën "Kameleonboekje" dhe "Meertalig opvoeden" (Prindërimi shumëgjuhësor).



Broshura Kameleon

Kjo broshurë do tu ndihmojë kur reflektoni mbi idenë që keni për të rritur fëmijën tuaj në ambjent shumëgjuhësor. Aty parashtrohet një plan i familjes tuaj dhe ambjentit përreth, dhe në këtë mënyrë ju mund të bëni një zgjedhje së bashku. Kjo për shkak se ka mënyra të ndryshme për të rritur fëmijën tuaj në ambjent shumëgjuhësor. Nuk ekziston vetëm një zgjedhje e drejtë.

Çdo familje është e ndryshme dhe bën zgjedhjen e saj. Por ka shumë aspekte që duhet të merren parasysh.



'Rritja e fëmijës në ambient shumëgjuhësor në familjen tonë'

1. Dëshirat tona

- Cilat gjuhë doni që të mësojë fëmija juaj? Dhe pse?
- Çfarë qëllimi kanë gjuhët e ndryshme?
- Kanë gjuhët e ndryshme të njëjtën rëndësi?
- Çfarë niveli duhet të ketë fëmija juaj në gjuhë të ndryshme?
- A ka çdokush prej jush në familje të njëjtat pritshmëri?

2. Kush flet çfarë gjuhë?

Fëmija mëson gjuhën që dëgjon kur i flisni. Këto gjuhë duhet të përdoren rregullisht.

- Prindi(ërit)
- Vëllezërit dhe motrat
- Gjyshërit
- Në çerdhe, kopsht
- Të tjerë (halla, teze, daja, xhaxhai, fqinjë, miq ...)

3. Ku, në ç'ambjete do të flasim çfarë gjuhe?

Ka mundësi që ju flisni gjuhë të ndryshme me fëmijën tuaj varësisht nga vendi ku jeni.

- Në shtëpi
- Në rrugë
- Kur jeni diku për vizitë
- Në çerdhe, kopsht
- Në shkollë

4. Zgjedhja jona

Si do ti mësojmë fëmijës tonë gjuhë të ndryshme?

- Cilat gjuhë?
- Me kë?
- Si, në çfarë mënyre?

Mundësitë janë 'një prind, një gjuhë, 'përzierje, "Flamisht dhe përzierje, 'gjuha amtare dhe përzierje, 'vetëm gjuhën amtare, 'tre gjuhë' ...

Shihni faqen tonë web për më shumë informata.



Broshura Shumëgjuhësia Të rritësh fëmijë shumëgjuhësorë: është fantastike!

Sa më shumë gjuhë aq më mirë!

Nga tingujt bebesh derinë fjalë dhe fjali: të mësosh një gjuhë është vërtet një mrekulli! Fëmija praktikon shumë me zërin e vet, por ka gjithashtu nevojë për tjerët për të mësuar një gjuhë.

Prindërit, vëllezërit dhe motrat, ata që kudesen për fëmijët ... ata që flasin shumë me fëmijët e ndihmojnë atë që të arrijnë një gjë të tillë. Fëmija që nga lindja mund të mësojë një apo më shumë gjuhë. Në mënyrë simultane apo konsektive.

Si prind ju ndoshta keni pyetje si të rrisni fëmijën në shumë gjuhë. Kjo broshurë ju inform dhe ju frymëzon. Aty përfshihen disa këshilla të cilat mund ti provoni menjëherë!

Zhvillimi gjuhësor mes moshës 0 dhe 3 vjeçare

Të mësosh të flasësh është vërtet një mrekulli! Bebja fillon në mënyrë të pandërgjegjshme të nxjerrë tingujt e para si bebe.

Dy vjet e gjysëm më vonë vogëlushi juaj flet pa pushim gjithë ditën dhe kupton shumë.

1. Gjatë shtatzanisë
 - Java 21: bebja është tashmë në gjendje tu dëgjojë!
2. Bebja 0-15 muaj
 - Tingujt e parë
 - Qan
 - Guget
 - Belbëzon: nga moshta prej 7 muajsh, bebja fillon të belbëzojë: 'da-da-da' dhe 'ma-ma-ma'.
 - Fjala e parë: rreth moshës një vjeçare, shqiptohen fjalët e para. Jo në mënyrë perfekte por të kuptueshme.
3. Vogëlush nga 15 muaj deri 3 vjeç
 - Shumë fjalë të reja
 - Fjalitë e para: rreth moshës 1.5 vjeç, fëmija juaj do të nxjerrë fjalitë e para prej 2 fjalësh.
 - Fjali më të gjata
4. Parashkollor nga 3 deri 6 vjeç
 - Fjali me 3 deri 5 fjalë.



Si mund ta ndihmoni fëmijën tuaj me zhvillimin gjuhësor?

1. Fol shumë me beben!

Bisedo me beben. Jepi kohë të reagojë.
Reago në zhurmat që bëjnë, lëvizjet... Sa më shumë që flet me fëmijën aq më shumë mundësi ka të mësojë gjuhë.

2. Fillo nga lindja

Fol me beben nga lindja! Megjithëse bebja vetë nuk flet mëson shumë nga gjuha.

3. Gjatë gjithë ditës!

Mund ti flisni bebes gjatë gjithë ditës. Kur ha apo e ushqen. Apo gjatë një shëtitjeje. Apo kur luani bashkë. Kjo është diçka spontane dhe e natyrshme.

4. Kur i tregon një përrallë, kur këndon, kur i lexon diçka ...

Ka mënyra të ndryshme për ta ndihmuar fëmijën me zhvillimin gjuhësor. Fëmijës i pëlqen shumë kur i këndon këngë. Është vërtet argëtuese kur lexoni një libër së bashku. Apo kur i tregoni një përrallë. Fëmija mëson fjalë të reja edhe në atë mënyrë.



Këshillë për prindërimin shumëgjuhësor

- Flisni me fëmijën tuaj në gjuhën apo gjuhët me të cilat ju ndiheni më rehat dhe të cilat i dini më së miri. Kur flisni dhe ndiheni të natyrshëm dhe spontan kjo ndihmon fëmijën tuaj në zhvillimin gjuhësor.
- Prindërimi shmëgjuhësor? Kur jeni shtatzënë, mendoni për funksionin e gjuhëve të ndryshme në familjen dhe mjedisin tuaj. Bëni marrëveshje se kush do ti flasë fëmijës në çfarë gjuhe apo gjuhësh.
- Sigurohuni që gjuhët e ndryshme të përdoren në mënyrë të mjaftueshme. Fëmija mëson gjuhën apo gjuhët që ju përdorni më së shumti kur flisni me të.
- Dini këngë, histori apo libra në gjuhën tuaj amtare? Bëni që edhe fëmija juaj të argëtohet me to! Kjo është mënyra si ia jepni gjuhën tuaj amtare fëmijës tuaj.
- Njohje e shumë e mirë e gjuhës amtare
Njohja shumë e mirë e gjuhës amtare krijon një bazë të fortë për të mësuar gjuhë të tjera. Biseda spontane mes prindit dhe fëmijës në gjuhën që përdoret në shtëpi ndihmojnë shumë për zhvillimin gjuhësor.
- Marrëveshje të qarta
Bëni marrëveshje të qarta kush flet çfarë gjuhe dhe në çfarë kohe. Në këtë mënyrë çdo gjuhë i jepet vëmendje e mjaftueshme. Nëse gjuhës amtare nuk i jepet vëmendje e mjaftueshme, ka gjasa që fëmija juaj nuk do të mësojë mirë apo edhe të harrojë shumicën e saj.
- Kontakti i parë me flamishten
Nëse nuk flisni flamisht në shtëpi, do të ishte ide e mirë që të çoni fëmijën disa ditë në çerdhe apo kopsht. Në këtë mënyrë fëmija ka dëgjuar flamisht para se të fillojë shkollën. Për më tepër, kjo ndihmon pozitivisht në mirëqënien e fëmijës tuaj! Fëmija juaj luan me fëmijë të tjerë dhe zbulon botën! Për më tepër ju si prind do të takoheni atje me prindër të tjerë.

- **Ndryshimet mes gjuhëve**
Një fëmijë që që flet shumë gjuhë nuk flet çdo gjuhë në të njëjtën mënyrë. Kjo është shumë e zakonshme! Kjo varet shumë nga mënyra si ato përballen me gjuhë të ndryshme dhe mundësitë që kanë për të përdorur gjuhët: leximi dhe shkrimi që kanë në shkollë, kur flasin në shkollë dhe në shtëpi ...

Pyetje? Kush mund tu kontaktojë nëse keni nevojë për ndihmë?

Nëse doni të flisni me dikë për këtë çështje kontaktoni 'Kind en Gezin' me pyetjet tuaja. Për këtë mund të flisni gjata seancave të konsultimit para apo pas lindjes apo gjatë vizitës në shtëpi.

Ose mund të shtroni pyetjet përmes linjës 'Kind en Gezin': 078 150 100.

Shkurtimisht: pyetjet tuaja janë të mirëseardhura!



Shtroni pyetjet përmes linjës 'Kind en Gezin': 078 150 100.

Ju mund të kontaktoni një punonjës së Kind en Gezin çdo ditë gjatë orarit zyrtar nga ora 8 në mëngjes deri në orën 8 në mbrëmje. Na dërgoni një e-mail përmes formularit kontaktues në kindengezin.be.